

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Albania DMC Tours” SHPK

Sot ne Tirane, ne date 30/09/2024, themeluesi i meposhtem:

Ani Murati, i datelindjes 27/09/1990 lindur ne Gramsh, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, pajisur me numer personal J00927059C, ka vendosur krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe nenshkruan Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me emrin “Albania DMC Tours” SHPK, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar, nga percaktimet ne kete Akt Themelimi dhe nga Statuti i saj.

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria “**Albania DMC Tours**” SHPK, eshte person juridik i se drejtes shqiptare. Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me poshte e quajtur “Shoqeria”.

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKR, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treveve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne: Rruga Arkitekt Sinani, Pallati 13/1 Ap 15, Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, me Vendim te Asamblese se Ortakeve dhe Vendim te Administratorit.

Neni 4
Kohezgjatja


Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 5
Objekti i veprimtarise

Shoqeria do kete si objekt te veprimtarise:

Operator turistik. Organizim dhe kryerje e veprimtarive te ndryshme me turiste vendas dhe te huaj Sherbim konsulence ne turizem dhe marketing. Turizem mjekesor. Organizim eventesh dhe konferencash ne terren dhe online. Blerje shitje hapesire publicitare.

Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji i zbatushem ne



Republiken e Shqiperise.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mijë) leke, i perbere nga një kuote e vetme me vlerë te per gjithshme **100.000 (njeqind mijë) leke**, e cila perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

*Ortaku themelues i Shoqerise "Albania DMC Tours" SHPK,
Ani Murati, eshte zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë 100.000 (njeqind mijë) leke, e cila perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.*

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Ortakut te vetem.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato Jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu Jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve nepermjet akteve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE


Neni 8

Organi Vendimmarres

1. Asambleja e Pergjithshme eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e me poshtme:

- a. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b. Ndryshimet e statutit;
- c. Emerimin e shkarkimin e administratorit/ve;
- ç. Emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d. Percaktimin e sferblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh. Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë. Zmadhimin dhe zvogelin e kapitalit;
- f. Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g. Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj. Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per çeshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "ë" te



- pikes 1 te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.
3. Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se per gjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b. Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c. Investime;
- ç. Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjitruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejoje pavlefshmerine te tretit qe ka fituar te drejta ne mirebesim, perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

4. Ortaku i vetem mund te perfakesohet edhe nga nje tjeter person, nepermjet prokures.

5. Mbledhja e zakonshme e asamblese se per gjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Neni 9 Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i vetem.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10 Administrimi

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem te shoqerise.

Ortaku i vetem vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/ret, mund te jene ose jo ortake te shoqerise.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo kohe.

Administrator i shoqerise eshte Z.Ani Murati, i datelindjes 27/09/1990.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e tij ne kete detyre per nje periudhe **5 (pese) vjeçare**, sipas ligjit.

Neni 11 Kompetencat e Administratorit

Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem.

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a. Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b. Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- c. Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- ç. Krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercendjne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

- d. Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- dh. Raportoje perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te Jashtezakonshem;
- ë. Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoritetete shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve;
- f. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimi i ortakeve te shoqerise;
- g. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj;
- gj. Administratori ka gjithashtu te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme ne emer e per llogari te Shoqerise, perfshire ketu kontratat e qirase, shitjes, blerjes, kredive a hipotekimit te pasurive te paluajtshme, te nenshkruaje aktet e themelimit te shoqerive te tjera ku Shoqeria eshte ortak;
- h. te nenshkruaje e hartoje çdo dokument e te kryeje ne emer te Shoqerise çdo veprim perballte te gjitha Bankave shqiptare apo te huaja ne lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhese te Shoqerise, nenshkrimi i kontratave te ndryshme bankare per financimin e Shoqerise si dhe te kryeje veprime terheqje e derdhje shumash nga keto llogari pa limit;
- i. Shoqeria nuk merr persiper pasojet ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke pasur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjafsheme;
- j. Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet;
- k. Administratorit ose ortakut qe nuk eshte person juridik, nuk u lejohet te kontraktojne ne çfareadolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradigmie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme;


Neni 12
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimi i viti i pare - finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 13
Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfarendo shkaku, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar siç mund te jene:

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesa e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj;
- b) Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"



4

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Ortaku i vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne qdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete Akt Themelimi dhe legjisacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne kete Akt Themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe qfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise qe ka lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise.

Neni 15
Dispozita Perfundimtare

Ky akt themelimi u hartua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejtave juridike, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare **"Albania DMC Tours" SHPK,**

ORTAKU THEMELUES

Ani Murati



A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized letters and a surname, is written above a horizontal line. Below the line, there is a more fluid, cursive signature that ends with a small arrow pointing to the right.